



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 22.24.1-2012-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË VUSHTRRIË
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2012

Prishtinë, Qershor 2013

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) kryen auditime të rregullsisë si dhe ato të performancës. Auditori i Përgjithshëm, Lage Olofsson, është kreu i ZAP-it që ka të punësuar rreth 140 anëtarë të stafit. Auditori i Përgjithshëm dhe ZAP janë të pavarur dhe që çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare për çdo vit, derisa ndërmarrin forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjerë të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga ZAP në mënyrë direkte promovojnë llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti mbajtur llogaridhënës menaxherët e organizatave individuale buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Komunës së Vushtrrisë në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm, Qerkin Morina, i cili ka bërë mbikëqyrjen e auditimit.

Opinionin dhe raportin i nxjerrë janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Florim Beqiri mbështetur nga Ramadan Gashi (Udhëheqës i ekipit), Enver Ramadani, dhe Qëndresa Sogojeva.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit.....	6
2 Pasqyrat vjetore financiare.....	7
3 Rekomandimet e vitit paraprak	11
4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli	12
5 Sistemi i auditimit të brendshëm	21
6 Konkluzioni i përgjithshëm	23
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZAP	24
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak.....	26

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF-të) për vitin 2012 për Komunën e Vushtrrisë. Me këtë rast, dëshiroj të falënderoj Kryetarin e Komunës dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Auditimi i PVF për vitin 2012 ishte ndërmarrë në përputhje me Standardet e njohura Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat për të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Auditimi është fokusuar në:

- PVF;
- Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm (duke përfshirë menaxhimin dhe ekzekutimin e buxhetit); dhe
- Sistemin e Auditimit të Brendshëm.

Opinion

Auditori i Përgjithshëm (AP) i raporton Kuvendit për opinionin e tij në formatin e përcaktuar në nën kapitullin 2.3 Opinioni i Auditimit. Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e ZAP. Raporti i AP-së përfshin një opinion për vërtetësinë dhe drejtësinë e PVF.

Sipas Opinioneve tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë *një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Si *Theksim i çështjes* Regjistri i Pasurive Fikse dhe pagesave nga palët e treta ende nuk është plotësisht i besueshëm. Regjistri i pasurive fikse dhe pagesave nga palët e treta nuk ka ndikim në ndonjëren prej 2 Pasqyrave Vjetore Financiare (Pranimet dhe Pagesat e Parasë së Gatshme dhe Krahasimin e Buxhetit dhe Shumat Aktuale), në pajtim me IPSAS në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme. **(SNISA: 400 Opinion i Pakualifikuar me Theksim të Çështjes).**

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzioni jonë i përgjithshëm e pasqyron rishikimin tonë të kontrolleve të ndërlidhura me PVF-të, Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin si dhe Sistemin e Auditimit të Brendshëm.

Konkluzioni ynë është se Kryetari i Komunës kishte dizajnuar sistemin e kontrollit të brendshëm në nivel të knaqëshëm, por këto duhet në vazhdimësi të monitorohen për tu siguruar se janë duke funksionuar siç duhet. Janë vërejtur mangësitë në disa fusha të cilat janë përshkruar në raport.

Rekomandimet e auditimit kanë për qëllim ta mbështesin Komunën e Vushtrrisë në përmirësimin e kontrolleve financiare dhe rritjen e aspekteve tjera të aktivitetit operacional. Ne i kemi konsideruar përgjigjet ndaj rekomandimeve tona të bëra në vitin 2011 - pozita aktuale është përmbledhur në Shtojcën II. Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se kërkohet theks shtesë në implementimin e rekomandimeve të auditimit për t'iu shmangur dobësive të vazhdueshme të kontrollit.

Kemi diskutuar cilësinë e raportimit financiar të Komunës së Vushtrrisë dhe të gjeturat e tona të detajuara të auditimit në lidhje me Pasqyrat Vjetore Financiare, Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe Llogaridhënien e Menaxhmentit, si dhe Auditimin e Brendshëm në pjesën kryesore të këtij raporti.

Rekomandimet tona kryesore për Kryetarin e Komunës janë si në vijim:

Pasqyrat vjetore financiare

- Shpalosja e plotë të pasurive dhe pagesave nga palët e treta në PVF në pajtim me standardet dhe kërkesat ligjore në fuqi.

Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

- Që Kryetari i Komunës siguroj ndërmarrjen e masave të nevojshme për t'i adresuar të gjitha rekomandimet, dhe të forcoj të gjitha linjat e llogaridhënies;
- Të analizoj në mënyrë gjithëpërfshirëse çështjen e të hyrave, si në kuptimin e planifikimit ashtu edhe në vendosjen e mekanizmave efektiv për realizimin e parametrave të planifikuar;
- Kryetari i Komunës duhet të merr masa ndaj OE, që të respektojnë planin dinamik, ose në të kundërtën të aplikoj penalet ndaj tyre;
- Se dosjet e zyrtarëve të jenë azhurnuar mirë, vlerësimi i punëtorëve të kryhet në mënyrë periodike dhe njëjti të sistemohet në dosjen personale të zyrtarëve; dhe

-
- Të siguroj regjistrimin e gjithave pasurive të komunës, në pajtueshmëri me kërkesat e UA me Nr. 21/2009 për menaxhimin e pasurive qeveritare.

Sistemi i Auditimit të Brendshëm

- Të gjeturat dhe rekomandimet e dhëna nga auditimi i brendshëm dhe i jashtëm do të diskutohen dhe adresohen nga të gjitha nivelet e menaxhimit.

Përgjigje nga menaxhmenti – auditimi i vitit 2012

Menaxhmenti është pajtuar me të gjitha të gjeturat tona të auditimit dhe është zotuar se do ti adresojnë rekomandimet tona.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Është përgjegjësi e Komunës së Vushtrrisë të përgatis PVF sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshinë ekzaminimin dhe vlerësimin e PVF dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinionëve:

- Nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit ka reflektuar vlerësimin e rrezikut tonë të auditimit për Komunën e Vushtrrisë. Ne kemi konsideruar të kuptuarit tonë për organizatën, deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale dhe nivelin e testimit të hollësishëm të kërkuar gjatë përcaktimit të testimeve të përgjithshme e që janë të nevojshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmive për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Një vlerësim i përgjigjeve të Menaxhmentit ndaj rekomandimeve të bëra në vitin 2011 mund të gjendet në Shtojcën II.

Ne kemi përfshirë gjetjet e rëndësishme dhe të tjera më pak të rëndësishme, që dalin nga auditimi ynë. Për plotësinë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të 9 mujorit aty ku ishte relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të rëndësishme - Çështjet kryesore për vëmendjen e atyre që janë të ngarkuar me qeverisje dhe menaxhmenti i lartë e që mund të ketë potencial të rezultojë në një dobësi materiale në kontrollet e brendshme; dhe

Të tjera - Dobësitë e identifikuara në auditimin tonë, ku veprimi do të ofrojë potencialin për përmirësime në efikasitet dhe efektivitet të kontrolleve të brendshme.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe janë shtrirë vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një deklaratë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimet që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informatave të regjistruara në PVF. Ne gjithashtu e konsiderojmë deklaratën e bërë nga ZKA dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave vjetore financiare. Një numër i pikave në deklaratë kanë për qëllim të ofrojnë siguri për Qeverinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

2.1 Pajtueshmëria me kornizën raportuese

Konkluzioni i përgjithshëm

PVF ishin përgaditur në pajtim me kërkesat e Rregullës Financiare nr. 07/2011, dhe SNKSP “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” ku është

përdorur formati standard i raportimit, përveç çështjes së pasurive dhe pagesave nga palët e treta, ku e kemi trajtuar tek kapitulli cilësia dhe saktësia e informatave.

Përshkrimi

PVF duhet të jenë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese. Ne kemi vërejtur:

- Pajtueshmërinë me RrF Nr 07/2011;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048;
- PVF janë pranuar vetëm në gjuhën shqipe;
- PVF janë përgatitur në kopje fizike dhe elektronike; dhe
- Komuna ka përgatitur dhe ka dorëzuar raporte të rregullta tremujore tek Ministri i MF gjatë vitit 2012.

Rekomandim

Ne rekomandojmë Kryetarin e Komunës që me rastin e përgaditjes së PVF duhet merret parasysh edhe obligimi ligjor që PVF të përgaditen edhe në gjuhën serbe.

2.2 Cilësia dhe saktësia e informatave të prezantuara në pasqyrat vjetore financiare

Konkluzioni i përgjithshëm

Komuna ka arritur të përgatisë PVF sipas Rregullës Financiare nr. 07/2011 mbi raportimin vjetor të organizatave buxhetore, përveç pasurive dhe pagesave nga palët e treta. Në PVF të përgatitura nga Komuna, nuk kemi vërejtur ndonjë parregullsi domethënëse.

Përshkrimi

Si rezultat i punës sonë audituese, janë bërë rregullime në draft PVF të paraqitura për auditim. Ne kemi dhënë edhe një numër sugjerimesh tjera për të përmirësuar shpalosjet narrative dhe për të siguruar plotësinë e informacioneve shpjeguese të kërkuara si në vijim:

- Shpalosjeve të ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit;
- Shpalosjeve jo të sakta të pasqyra e obligimeve të papaguara.

Pas sugjerimeve tona, komuna ka bërë plotësimin e PVF me shpalosjet e duhura.

Të gjeturat dhe Rekomandimet

1. Çështja - Prezantimi i PVF - Prioriteti i rëndësishëm

- E gjetura** Neni 12-Pasqyra e pranimeve dhe pagesave me para të gatshme, kemi vërejtur se shpalosja e pagesave nga palët e treta, nuk është e plotë dhe e sakët e prezentuar në PVF. Vlera e pagesave të ekzekutuara prej 133,400€ ishte bërë nga MPMS si investime kapitale për komunën e Vushtrrisë, mirëpo ato nuk ishin prezantuar në kolonën e pagesave nga palët e treta.
- Rreziku** Mos prezentimi i plotë i pagesave nga palët e treta në PVF, është një mangësi informatash dhe bënë që këto pasqyra të jenë jo të plota dhe të sakta.
- Rekomandimi 1** Kryetari i Komunës duhet të siguroj që të gjitha pagesat nga palët e treta janë regjistruar dhe prezentuar në mënyrë korrekte në PVF, sipas formatit standard të raportimit.

2. Çështja - Prezantimi i PVF - Prioriteti i rëndësishëm

- E gjetura** Në shënimin 30-Përmbledhja e pasurive jo-financiare, vlera e pasurive prej 36,639,248€, nuk është e plotë dhe e saktë sepse ende nuk është bërë regjistrimi i pasurive të financuara nga ministritë e linjës.
- Rreziku** Mos prezantimi korrekt i vlerës së pasurive shpie në keqkuptimin e pozitës financiare të komunës, si dhe mundësinë e keqkuptimit të kërkesave buxhetore në të ardhmën. Kjo nuk ka ndikim në dhënien e opinionit, por si çështje duhet të jetë në vëmendjen e menaxhmentit.
- Rekomandimi 2** Kryetari i Komunës duhet të sigurojë se plani sistematik i përpilimit të PVF inkorporon kërkesën për të përfshirë tërë vlerën e pasurive. Menaxhmenti ka nevojë të monitoroj zbatimin e kësaj kërkesë.

2.3 Opinioni i Auditimit

Sipas Opinionit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë *një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Si *Theksim i çështjes* Regjistri i Pasurive Fikse dhe pagesave nga palët e treta ende nuk është plotësisht i besueshëm. Regjistri i pasurive fikse dhe pagesave nga palët e treta nuk ka ndikim në ndonjëren prej 2 Pasqyrave Vjetore Financiare (Pranimet dhe Pagesat e Parasë së Gatshme dhe Krahasimin e Buxhetit dhe Shumat Aktuale), në pajtim me IPSAS në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme. **(SNISA: 400 Opinion i Pakualifikuar me Theksim të Çështjes).**

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Kryetari i komunës kishte trajtuar me kujdes rekomandimet e dhëna në vitin e kaluar, dhe ne vlerësojmë këtë përkushtim, por mbetet sfidë edhe më tutje adresimi i plotë i rekomandimeve të dhëna.

Përshkrimi

Raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2011 të Komunës kanë rezultuar në 10 rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi duke theksuar se të gjitha rekomandimet duhet të adresohen.

Në fund të auditimit për 2012, katër (4) prej tyre janë adresuar plotësisht; pesë (5) janë adresuar pjesërisht, dhe një (1) nuk është adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe se si janë adresuar ato, shih Shtojcën II.

Të gjeturat dhe Rekomandimet

3. Çështja - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak-Prioriteti i rëndësishëm.

E gjetura	Komuna nuk ka arritur t'i adresoj në mënyrë të plotë të gjitha rekomandimet e dhëna në vitin e kaluar.
Rreziku	Mos adresimi i plotë i të gjitha rekomandimeve, duke marrë për bazë planin e veprimit rritë rrezikun që mangësitë e njëjta të vazhdojnë të përsëriten, e po ashtu do të përsëriten edhe rekomandimet për fushat përkatëse.
Rekomandimi 3	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani i veprimit i rishikuar në mënyrë të qartë përcakton një afat kohor për adresimin e rekomandimeve me anëtarët e stafit llogaridhënës, të identifikuar - me fokus fillestar në ato të një rëndësie të madhe.

4 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

4.1 Hyrje

Qasja jonë e auditimit është fokusuar në të kuptuarit dhe vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti për të siguruar menaxhim financiar dhe kontroll efektiv. Për sisteme individuale financiare, ne kërkojmë të identifikojmë nivelin në të cilin operojnë kontrollet aktuale. Kjo mund, për shembull, të jetë aktiviteti monitorues i ndërmarrë nga menaxhmenti i lartë apo kontrolleve operative të nivelit më të ulët. Ne konsiderojmë se kontrollet janë të dizajnuara mirë, janë zbatuar siç është planifikuar dhe funksionojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjat e llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti.

4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Konkluzioni i përgjithshëm

Komuna nga buxheti prej 13,199,930€, kishte arritur t'i shpenzoj gjithsej 12,046,196€ apo 91% nga shuma totale. Kjo flet se komuna ka shfrytëzuar buxhetin në nivel shumë të mirë.

Përshkrimi

Ne kemi konsideruar burimin e fondeve buxhetore për komunën, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrave të mbledhura. Kjo është theksuar në tabelat e më poshtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në Euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2012 Shpenzimi	2011 Shpenzimi	2010 Shpenzimi
Burimet e Fondeve:	12,492,512	13,199,930	12,046,196	12,365,622	9,955,030
Granti i Qeverisë-Buxheti	10,720,512	10,910,512	10,857,784	11,009,393	8,793,599
Të bartura nga viti paraprak		398,087 ²	358,838	305,868	309,898
Të hyrat vetjake	1,772,000	1,772,000 ³	753,292	859,060	776,616
Donacionet Vendore		93,537	60,969	145,758	74,917
Donacionet e Jashtme		25,794	15,313	45,543	-

Nga tabela 1 shihet se ka ndryshim në mes buxhetit fillestar dhe atij final për 707,418€. Ky ndryshim i buxhetit ka ardhur si rezultat i të hyrave vetjake të bartura nga viti 2011 në vlerë prej 398,087€, nga donacionet në vlerë 119,331€, dhe rritja e grantit qeveritar 190,000€.

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

² Të hyrat e bartura nga viti i kaluar

³ Të hyrat vetjake të planifikuara

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në Euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2012 Realizimi	2011 Realizimi	2010 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	12,492,512	13,199,930	12,046,196	12,365,622	9,955,030
Pagat dhe Mëditjet	7,222,060	7,254,039	7,222,254	6,896,395	5,500,160
Mallrat dhe Shërbimet	1,062,744	1,324,963	1,214,565	1,050,628	888,330
Komunalitë	274,750	287,750	189,685	214,660	228,010
Subvencionet dhe Transferet	109,863	127,863	127,753	159,853	155,830
Investimet Kapitale	3,823,095	4,205,315	3,291,939	4,044,086	3,182,700

Një ngecje në realizimin e objektivave buxhetore vërehet te investimet kapitale, ku janë shpenzuar 78% nga ajo që ishte planifikuar. Po ashtu, dhe të kategoria e komunalive janë shpenzuar 66% e buxhetit të planifikuar.

Tabela 3. Të hyrat vetjake të buxhetuara dhe realizuara (në Euro)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2012 Realizimi	2011 Realizimi	2010 Realizimi
Të hyrat vetjake	1,772,000	1,772,000	1,157,577	1,240,745€	1,091,022

Komuna kishte arrit që ti inkasoj vetëm 65% e të hyrave vetjake ndaj atyre të planifikuara.

4.3 Kërkesat e raportimit

Konkluzioni i përgjithshëm

Sa i përket kërkesave të raportimit financiar, mund të konkludojmë se kërkesat që dalin nga legjislacioni në fuqi, komuna i ka përmbushur dhe ka respektuar afatet e kërkuara.

Përshkrim

Obligimet e përmbushura janë paraqitur në vijim:

- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore me kohë;
- Draft Plani dhe plani përfundimtar i prokurimit me kohë;

-
- Raportin e vetëvlerësimit;
 - Raportet mbi borxhet e dorëzuara në MF; dhe
 - Pasqyrat e obligimeve të papaguara.

4.4 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetjake)

Konkluzion i përgjithshëm mbi të hyrat

Komuna e Vushtrrisë, sa i përket të hyrave, ka kontolle të vendosura në nivele të ndryshme prej inkasimit të të hyrave deri tek raportimi në PVF, por performanca në tërësi edhe më tutje duhet të përmirësohet. Në veçanti përmirësimet janë të nevojshme në planifikimin e të hyrave si dhe në vendosjen e mekanizmave efektiv për mbledhjen sa më efikase të të hyrave.

Përshkrimi

Komuna e Vushtrrisë gjatë vitit 2012, ka realizuar të hyra në shumë prej 1,157,577€, derisa të hyrat e planifikuara për vitin 2012 ishin 1,772,000€.

Të gjeturat dhe Rekomandimet

4. Çështja - Të hyrat e planifikuara - Prioriteti i rëndësishëm

- | | |
|----------------------|---|
| E gjetura | Komuna ka planifikuar që të realizoj të hyra gjatë vitit 2012 shumë prej 1,772,000€, ndërsa kishte realizuar shumë prej 1,157,577€ apo 65% nga sa ishin planifikuar. Gjithashtu, kemi vërejtur se të hyrat e mbledhura të vitit 2012 janë për 83,163€ më të ulta se në vitin e kaluar. Menaxhmenti nuk ishte në gjendje të ofroj shpjegimet e duhura pse ka rënie të të hyrave në krahasim me vitin 2011. |
| Rreziku | Dështimi në mbledhjen e të hyrave, rrezikon edhe dështimin e projekteve të komunës, të planifikuara për t'u financuar nga burim e mjeteve vetjake. |
| Rekomandimi 4 | Kryetari i Komunës duhet të analizoj në mënyrë gjithëpërfshirëse çështjen e të hyrave, si në kuptimin e planifikimit ashtu edhe në vendosjen e mekanizmave efektiv për realizimin e parametrave të planifikuar. |

5. Çështja - Taksa nga mësimi jo formal të pa bazuara në rregullore - Prioriteti i rëndësishëm

- E gjetura** Gjatë testimit të 9 mostrave kemi identifikuar se shkolla SHMT „Lutfi Musiqi” ka inkasuar nga 8€ për çdo lëndë, 7 (shtatë) përftuesve të arsimimit për të rritur. Këtë tarifë nuk e parasheh fare UA 11/2011 i MASHT-it.
- Rreziku** Pagesat e marra nga përfituesit nuk ishin në pajtim me UA 11/2011.
- Rekomandimi 5** Të zbatohet Ligji nr. 02/L-24 për arsimimin dhe aftësimin për të rritur dhe UA 11/2011 neni 2 i MASHT-it për participimin e vijuesve të arsimit dhe aftësimin për të rritur.

4.5 Shpenzimet

Konkluzion i përgjithshëm mbi shpenzimet

Sipas vlerësimeve tona, komuna ka vendosur kontrolle të mira të sistemeve në këtë fushë. Pavarësisht kësaj, kërkohet përmirësim i mëtejshëm në fushën e kontrolleve të prokurimit, ngase janë vërejtur disa mangësi të natyrës administrative dhe monitorimit të aktiviteteve.

4.5.1 Prokurimi

Përshkrimi

Kontratat e nënshkruar përmes procedurave të prokurimit për vitin 2012 ishin 7,312,634€.

Ne kemi ekzaminuar blerjet prej 1,093,842€, që janë zhvilluar përmes procedurave të prokurimit dhe i kemi testuar pagesat lidhur më këto kontrata.

Të gjeturat dhe Rekomandimet

6. Çështja - Vonesat në kryrjen e punimeve dhe dorëzimin e pajisjeve - Prioritet i rëndësishëm

E gjetura Te lëndët „Ndërtimi me kubza betoni” i rrugëve sipas llotove 1,2,3,4,5,” në vlerë të kontratës prej 193,736€ dhe “Asfaltimi i rrugës lokale në fshatin Smrekonicë” në vlerë prej 89,951€, kemi vërejtur vonesa në kryrjen e punimeve sepse nuk ishte respektuar plani dinamik i paraparë me kontratë prej jo më shumë se 40 ditë.

Vonesë prej 10 ditësh për dorëzimin e pajisjeve është vërejtur edhe te kontrata „Furnizimi me pajisje për matjen e zhurmës” në vlerë prej 4,350€.

Rreziku Mos respektimi i planit dinamik rrit rrezikun që komuna të dështoj në realizimin me kohë të investimeve kapitale dhe të objektivave buxhetore. Gjithashtu, ndikim të njëjtë kanë edhe vonesat në dorëzimin e pajisjeve.

Rekomandimi 6 Kryetari i Komunës duhet të rishikoj rastet e tilla dhe të merr masa ndaj OE, që të respektojnë planin dinamik, ose në të kundërtën të aplikoj penalet ndaj OE.

7. Çështja - Lidhja e dy kontratave për furnizim me material zyrtar të ngjajshëm - Prioritet i tjetër

Rreziku Të lënda „Furnizime me material zyrtar” në vlerë të kontratës prej 2,610€, kemi vërejtur se komuna ka lidhur kontratë të re, me të njëjtë OE, edhe pse ka ekzistuar kontratë për furnizime e lidhur më herët për gjithë vitin.

Rreziku Kontrata e lidhura me të njëjtin OE, për furnizime të njëjta, është tregues që komuna nuk ka kontrollë të duhura gjatë planifikimeve të furnizimeve me material zyrtar.

Rekomandimi 7 Kryetari i Komunës duhet të siguroj kontrollë adekuate në këtë fushë, dhe mos nënshkruaj kontratë për furnizime me OE, derisa ekziston kontratat e nënshkruara më herët.

8. Çështja - Nuk është formuar komisioni për pranim të shërbimeve- Prioritet tjetër

E gjetura Te kontratat „Mirëmbajtja e rrugëve” në shumë prej 2,280€, dhe “Furnizim me derivate për ngrohje” në shumë prej 9,563€, komuna nuk kishte formuar komisione për pranimin e mallrave dhe shërbimeve të ofruara nga OE.

Te kontrata „Furnizimin me pije dhe ushqim për çerdhe” të dt. 05/04/2012 në vlerë prej 2,179€ nuk ishte formuar ndonjë komision për pranimin e mallit, por malli ishte pranuar vetëm nga ana e një zyrtari.

Rreziku Mungesa e komisionit për pranimin e mallrave, shërbime dhe punë rrit rrezikun që kontratat të mos respektohen nga ana e operatorëve dhe të mos pranohen sasi të cilësia e kontraktuara.

Rekomandimi 8 Kryetari i Komunës duhet të vendos procedura të kontrolleve me rastin e pranimit të mallrave, shërbimeve dhe punëve për t’u siguruar se kontratat po respektohen nga palët kontraktuese.

9. Çështja - Mungesa e një regjistri për funizime-Prioritet tjetër

E gjetura Kemi vërejtur që faturat e operatorit ekonomik që mirëmban bufen e komunës nuk përmbajnë emërtimet dhe çmimet e pijeve siç parashihet më kontratë. Bashkangjitur me faturë nuk ka një regjistër të pijeve të shpenzuara sipas drejtorive.

Rreziku Mungesa e regjistrit dhe çmimit të pijeve të shpenzuara nga drejtoritë, rrit rrezikun për tejkalimin e limiteve të pëcaktuara për pije dhe rritjen e shpenzimeve.

Rekomandimi 9 Kryetari i Komunës duhet të siguroj zbatimin e kushteve të kontratës me të gjitha elementet përkatëse, me kërkesën ndaj operatorit që të specifikoj të gjitha llojet e artikujve në faturat përcjellëse.

4.5.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Për kategorinë paga dhe mëditje buxheti final ishte 7,254,039€ ndërsa janë shpenzuar 7,222,255€, apo 99%..

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar (payrollit). Kontrollat që operojnë në nivel lokal nga komuna kanë të bëjnë me: a) kontrollimi i pagesave çdo muaj

duke e nënshkruar listën e pagave b) verifikimin e ndryshimit të mundshme që mund të paraqiten përmes formularëve c) rishikimin e buxhetit për këtë kategori dhe të bëhen barazimet me thesarin.

Për këtë kategori testuam 50 mostra nga administrata komunale dhe drejtorja e arsimit ku rishikuam se a janë në pajtueshmëri listat e pagave me sistemin e payrollit në MAP.

Të gjeturat dhe Rekomandimet

10. Çështja - Dosjet jo të azhurnuar mirë - Prioriteti tjetër

E gjetura Në dosjet e personelit nëpër shkolla kemi vërejtur mangësi në mbajtjen e dosjeve, ku prej tyre në 18 dosje mungon vlerësimi vjetor, në 3 dosje mungon kalkulimi i pushimit vjetor. Gjithashtu, procesverbalet e rekrutimit të mësimdhënësve, nuk janë mirëfillta (protokoluara), por mbahen vetëm në fletrore.

Rreziku Zyra e personelit nuk ka azhurnuar dosjen e personelit dhe për pasojë mund të ndodhin pagesa jo korrekte.

Rekomandimi 10 Kryetari i Komunës duhet të siguroj se dosjet e zyrtarëve të jenë azhurnuar mirë, vlerësimi i punëtorëve të kryhet në mënyrë periodike dhe rekrutimet e stafit të jenë mirë të dokumentuara.

11. Çështja - Akt-emërimi dhe kontratat e punës-Prioritet tjetër.

E gjetura Kemi vërejtur se (4) katër shërbyesëve civil ju mungojnë akt-emërimet dhe (4) katër mësimdhënësëve ju mungojnë kontratat e punës për vitin 2012, edhe pse janë në marrëdhënie pune.

Rreziku Të dhënat nuk janë në dispozicion për të justifikuar pagesat e pagave.

Rekomandimi 11 Kryetari i Komunës duhet të përcaktoj pse dështimet në proces kanë ndodhur dhe t'i shtoj kontrollet që të shmang përsëritjen e tyre.

4.5.3 Subvencionet dhe Transferet

Përshkrimi

Komuna për vitin 2012 kishte buxhetuar nga kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve shumë prej 127,863€, nga të cilat janë shpenzuar 127,753€ apo 99% të buxhetit të planifikuar. Këto subvencione ndahen kryesisht për entitete publike dhe entitete jo publike (individ) në bazë të rregullorës së brendshme për subvencione. Gjatë auditimit të mostrave të marrura në nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për të raportuar.

4.6 Pasuritë

Konkluzioni i përgjithshëm mbi pasuritë

Komuna ka bërë një progres për regjistrimin e pasurive në krahasim me vitin paraprak, mirëpo, nuk kishte arritur të regjistroj pasuritë e financuara nga ministritë e linjës (Qeverisja Qëndrore) në projektet e ndryshme kapitale në territorin e komunës.

4.6.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Komuna ka dy zyrtar të çertifikuar për mbajtjen, ruajtjen dhe regjistrimin e pasurisë. Në kemi vërejtur se komuna ka regjistruar pasuritë në SIMFK, ku vlera neto në libra është 36,639,248€.

Të gjeturat dhe Rekomandimet

12. Çështja - Mungesa e dokumentacionit për projektet financuese nga qeverisje qendrore-Prioriteti i rëndësishëm

E gjetura Komuna mbanë regjistër të pasurive, mirëpo ky regjistër nuk ishte i plotë dhe gjithëpërfshirës për faktin se shumë projekte kapitale (shkolla, shtëpi shëndeti, asfaltim rrugësh, etj.) të financuara nga Ministritë e ndryshme, nuk ishin regjistruar. Sipas zyrtarëve kjo gjendje ka ardhur si rezultat i mos koordinimit dhe bashkëpunimit të komunës me institucionet tjera.

Rreziku Bashkëpunimi i dobët në mes komunës dhe institucioneve tjera qeveritare, rezulton me mengësi informatash në regjistrin e pasurive dhe nuk siguron menaxhim efektiv të pasurive. Mungesa e një regjistri të tillë ka ndikuar edhe në shpalosjen jo të drejtë në PVF.

Rekomandimi 12 Kryetari i Komunës duhet të siguroj regjistrimin e të gjithave pasurive të komunës, në pajtueshmëri me kërkesat e UA me Nr. 21/2009 për menaxhimin e pasurive qeveritare.

4.7 Trajtimi i borxheve

Konkluzioni i përgjithshëm mbi trajtimin e borxheve

Komuna kishte arrit t'i menaxhoj borxhet në mënyrë mjaft efektive dhe në evidencat e saj gjinden disa borxhe të cilat janë evidentuar kryesisht gjatë ditëve të fundit të vitit.

Përshkrim

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnizuesve në fund të vitit 2012 ishte 40,020€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2013. Mallrat dhe shërbimet 25,920€, shpenzimet komunale 2,600€, subvencionet dhe trasferet 11,500€.

5 Sistemi i auditimit të brendshëm

Konkluzion i përgjithshëm mbi sistemin e auditimit të brendshëm

Njësia e auditimit të brendshëm ka një staf prej dy vetash: auditorit dhe drejtorit të NJAB. Puna e kryer nga auditimi i brendshëm konsiderohet e mirë dhe i kishte kontribuar kontrolleve të brendshme në korrigjimin e disa dobësive.

Përshkrimi

NJAB për vitin 2012 kishte planifikuar dhe kishte të kryer 5 auditime të rregullta dhe një ad hoc, të cilat kanë mbuluar vitin 2012. Auditimet ishin kryer: (a) Të hyrat në drejtorinë e Urbanizmit, (b) të hyrat në drejtorin e Katastrit, (c) auditimi në zyrën e prokurimit, (d) Rishikimi i sistemit të kontrollit të brendshëm në drejtorinë e thesarit, buxhet dhe financa dhe (e) auditimi në zyrën e prokurimit faza e dytë.

Gjithashtu me vendim të Kryetarit NJAB kishte kryer auditimin ad hoc për inkasimi i hyrave në palestrën sportive gjatë viti 2012.

Gjatë testimit kemi vërejtur se nga këto 6 raporte janë dhënë 20 rekomandime, prej të cilave 9 prej tyre janë zbatuar plotësisht, 5 proces dhe 6 të pa implementuar.

Të gjeturat dhe Rekomandimet

13. Çështja - Mungesa e një plani të veprimit - Prioritet i rëndësishëm

E gjetura Si rezultat i punës sonë audituese nuk kemi verejtur se menaxhmenti ka bërë ndonjë plan veprimi për adresimin e rekomandimeve nga NJAB.

Rreziku Mospërgatitja e një plani të veprimit dhe adresimi i rekomandimeve rrit rrezikun që dobësitë e njëjta të përsëriten vit pas viti.

Rekomandimi 13 Kryetari i Komunës duhet të bëjë planin e veprimit, i cili duhet të zbatohet, duke i caktuar zyrtarët përgjegjës dhe kohën për kryerjen e veprimeve për rekomandimeve të dhëna nga NJAB.

6 Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzioni ynë është se Kryetari i Komunës kishte dizajnuar sistemin e kontrollit të brendshëm në nivel të knaqëshëm, por kontrollet ka nevojë të monitorohen në vazhdimësi për tu siguruar se janë duke funksionuar siç duhet. Në vazhdim po i paraqesim fushat në të cilat janë vërejtur mangësitë e përshkruara në këtë raport.

Pagesat nga palët e treta duhet të regjistrohen në regjistrat kontabël si dhe të shpalosen drejtë në PVF. Përveç kësaj, shpalosjet e pasurive gjithashtu duhet të bëhen në shuma të plota dhe të sakta.

Rekomandimet janë adresuar vetëm pjesërisht, dhe ne mendojmë se menaxhmenti duhet të adresoj zbatimin e tyre në të gjitha nivelet e menaxhimit, me kërkesën që ato të përmbushen maksimalisht, me theks të veçantë ato me rëndësi prioritare. Plan veprimi duhet bëhet edhe për rekomandimet e auditimit të brendshëm.

Buxheti ka nevojë të përmirësohet në fazën e ekzekutimit. Dobësi të ekzekutimit shihen tek buxheti për shpenzimet kapitale i cili ishte shpenzuar vetëm 78% dhe komunalitë prej 66%.

Menaxhmenti kishte një performancë të dobët sidomos në inkasimin e të hyrave, ku kishte arritur të realizoj vetëm 65% të planit. Për më shumë, është vërejtur një rënie e të hyrave në krahasim me vitin 2011. Disa inkasime janë bërë pa një bazë të qartë ligjore, siç është rasti me tarifata e paguara për mësim jo formal në sektorin e arsimit.

Në fushën e prokurimit, vërehen poashtu disa mangësi. Përveç, mungesës së komisioneve për pranim të mallrave, shërbimeve dhe punëve, në raste të caktuara kishte edhe disa vonesa në realizimin e projekteve.

Departamenti i personelit duhet të kompletoj dhe azhurnoj dosjet, për t'iu shmangur pagesave të parregullta si dhe për të mundësuar sigurimin e stafit më të përshtatshëm.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. Një **opinion i pakualifikuar** jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. **Theksi i çështjeve.** Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo komplete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. **Opinion i Kualifikuar.** Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. **Opinion i Kundërt.** Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionin që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. **Mohimi i Opinionit.** Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bënë të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotesisht te adresuara	Rekomandimet pjeserisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
5. Pasqyrat Financiare.	Se pasqyrat vjetore financiare janë në pajtim me rregullat financiare dhe SNKSP sipas bazës së keshit, duke përfshir edhe të hyrat dhe shpalosjet e kërkuara.	X		
6.1 Të hyrat	<ul style="list-style-type: none"> Në marrjen e masave për rritjen e normës së inkasimit të të hyrave nga taksa e bizneseve dhe tatimit në pronë, dhe Të përmirësoj politikat buxhetore përkitazi me shpenzimet e të hyrave vetjake. 		X	
6.2.1 Spenzimet-Prokurimi	<ul style="list-style-type: none"> Që pagesat të kryhen vetëm pasi të jenë pranuar raportet për mallrat e pranuar, Emëroi një komision i veçantë për çdo furnizim me naftë për ngrohje në mënyrë që të konfirmohet sasia 	X		

	dhe cilësia e furnizimit, me theks të veçantë për furnizim me naftë për ngrohje.			
--	--	--	--	--

6.2.2 Blerjet tjera.	<ul style="list-style-type: none"> Që për të gjitha shpenzimet të mbahen dëshmi relevante dhe ato të bëhen në pajtueshmëri me ligjet në fuqi. 	X		
6.2.4 Subvencionet	<ul style="list-style-type: none"> Rregulloren e KK-së për ndarjen e subvencioneve të komunës. Çdo subvencion të këtë marrëveshje mirëkuptimi;dhe Përfituesve të ju kërkohet raporte kthyesë financiare. 	X		X
6.3 Pasuritë	Regjistrimin e të gjitha pasurive të komunës,në pajtueshmëri me kërkesat e UA 21/2009 për menaxhimin e pasurive qeveritarë.		X	
6.4 Borxhet	Se do të paguhen faturat brenda afatit ligjor prej 30 ditësh.		X	
7.1 Sistemi i kontrollit brendshëm.	Rishikohen kontrollet e brendshme dhe nxjerrja e politikave dhe procedurave specifike me qëllim përmirësimi i kontrolleve.		X	

7.2 Auditimi i brendshem.	<ul style="list-style-type: none"> • Ne në vazhdimësi mbështesim NJAB dhe bashkëpunojnë ngushtë dhe te adresoj rekomandimet e NJAB. 		X	
8. Konkluzioni i përgjithshëm.	Te nxjerr politika dhe procedura dhe udhezime të qarta për gjitha proceset dhe aktivitetet në Komunë.		X	

